



# INTERREG III A ITALI-SHQIPERI 2000-2006

“BiblioDoc-Inn”



QEMAL BAHOLLI

## Elbasani në fokus

Monumentet e qytetit të Elbasanit dhe rëndësia  
historike e tyre

Shtator – Dhjetor 2006

Redaktorë: Steliana Sinani, Ornela Bardhi, Oligerta Cankja, Manola Lleshanaku  
Përkthyes: Marsida Jashari

Drejtoreshë e Bibliotekës Publike të Elbasanit “Qemal Baholli”: Drita Cankja

Konsulente:



Antonio Lovecchio, Luigi Antonio Colecchia

Partner: Koperativa e Shërbimeve Kulturore Ninive

Një vend të veçantë në mirëbërësinë e Elbasanit zë emri i tregtarit Nazif Baholli, i cili ia ngriti lart emrin vetes me dhuratën shumë të çmuar, që i bëri qytetit të Elbasanit. Në perkujtim të të birit, Nazifi, si patriot me ide përparimtare, pati idenë të ngrinte në Elbasan një vepër kulturore, biblioteke publike, duke e pagëzuar me emrin e të birit: “Qemal Baholli”. Në fondet e saj fillimisht u futën 1000 vëllime.



## INTERREG III ITALI-SHQIPERI<sup>1</sup>

### **“Promovimi dhe zhvillimi i modeleve inovative të bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit italo-shqiptare” (BiblioDoc-Inn) Aksi IV – Mizura 4.1 – Aksioni 4 – Nën Aksioni 4.1**

Financuar nga Bashkimi Europian, projekti shënon arritje në drejtim të bashkëpunimit institucional të bibliotekave shqiptare me ato italiane. Ai promovon forma të bashkëpunimit ndërrajonal, krijon mundësira të njohjes së kulturave të dy popujve, të integritit të bibliotekave shqiptare në rrjedhën e atyre europiane. Në këtë projekt janë përfshirë Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, biblioteka publike “Qemal Baholli” e qytetit të Elbasanit dhe biblioteka publike “Marin Barleti” e qytetit të Shkodrës.

#### ***Projekti synon arritjen e objektivave të tillë si:***

- Zbatimin e të drejtës për akses në informacion, të garantuara nga Bashkimi Europian, në dobi të qytetarëve në përgjithësi;
- Lehtësimin e procesit të integritit europian përmes një informacioni të saktë mbi probleme të bashkësisë me interes të veçantë për bashkëpunimin ndërkufitar;
- Zvogëlimin e “dallimeve digjitale” përmes zbatimit të shpërndarjes së teknologjisë infotelematike në administrimin publik në dobi të zonave më të prapambetura;
- Promovimin e trashëgimisë biblio-dokumentare në përgjithësi, veçanërisht asaj të përcaktuar si vlerë kulturore;
- Modernizimin në planin e administrimit, përmirësimin cilësor dhe rritjen e shërbimeve publike.

Për arritjen e këtyre objektivave projekti parashikon realizimin e një programi për hartimin e buletineve tematike periodike dygjuhëshe, kryesisht për konsultim në [www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn.htm](http://www.bcr.puglia.it/pem/bibliodocinn.htm), por edhe për konvertim në letër në përshtatje me shërbimet tradicionale të bibliotekave të përfshira në projekt; si edhe realizimin e një programi për hartimin e botimeve profesionale.

---

<sup>1</sup> Në konferencën e mbajtur në Bari më 11-12 tetor të vitit 2001 në kuadër të INTERREG II, u vu në dukje gjendja e vështirë e bibliotekave publike në Shqipëri. Rruga më e sigurtë dhe më efektive për rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e drejtimit bibliotekar është përfshirja e drejtpërdrejtë e disa bibliotekave publike dhe qendrave shqiptare të dokumentacionit në struktura-pilot përmes të cilave të pasqyrohen risitë dhe të konsolidohen në territorin shqiptar modele që nxitin zhvillim në këtë fushë.

**Treguesi**

*Abstrakte* ----- fq. 4

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Fondi i shfrytëzuar për punimin e këtij materiali është marrë nga fondi i bibliotekës së Elbasanit "Qemal Baholli"



Abstracts

**Elbasani Enciklopedi, Elbasan/** Kujtim Bevapi, Ali Lazareni, Reshit Koburja, Tomorr Jolldashi, Zeqir Sarja;red. Xhevat Lloshi.-Elbasan: Sejko, 2003. – 710 fq. ; 25 cm.

**Indeks:** \*Rrapi I Bezistanit\* Monumenti I Kostandin Kristoforidhit\* Monumenti i Aqif Pashes\* Monumenti i Isuf Myzyri\* Urat antike\* Urat mesjetare\* Keshjtjella e Mengelit\* Kalaja e Skampis\* Kulla monumentale e ores\* Kalaja e Qafes ne Sulove\* Manastiri I Gjon Vladimirit\* Muzeu I shkolles Normale\* Stema e Karl Topias\* Statuti I korporates se tabakeve\* Xhamia Mbreterore\* Namazgjaja\* Teqja e Baba Xhemalit (1929)\* Teqja e madhe (1803)\* Monumentet e qytetit te Elbasanit\* Bazilikata e Klosit\* Muzeu historik

Momumentet e kulturës janë të gjitha objektet që përmbajnë vlera historike, kulturore, artistike e natyrore. Karakteristikat që I cilësojnë këto objekte si monumente kulture dhe I dallojnë nga të tjerët, janë vlerat

- 1- historike mjedisore (mjedisore dhe objekte historike,natyrore) si Rrapi I Bezistanit, Kalaja, Ullishta, Parku, Busheku, shtëpitë e figurave të shquara, banesa që dëshmojnë ngjarje historike ,
- 2- arkeologjike (vegla pune, objekte të përdorimit familjar, punime artistike, qendra banimi të hershme etj)
- 3- etnografike(veshje,zbukurime në gdhendje,punime artizanale,argjendarie)
- 4- arkitektunore dhe ndërtimore qytetare(banesa tipike qytetare për periudhat e kaluara, rrugë, cesma, shkolla, objekte të kultit fetar, objekte symbol për qytetin).

### **Rrapi I Bezistanit**

Ndodhet në qendër të qytetit. Emërtimi I tij lidhet me tregun e mbyyllum, I quajtur bezistan, bërthamë e rëndësishme tregtare, ndërtuar në shek.XVII, që përfshinte një numër të konsiderueshëm dyqanesh. Historikisht ka shërbyer si pikë referimi për ngjarjet historike, arsimore e kulturore të Elbasanit. Të gjitha këto janë pasqyrë e së kaluarës së tyre historike-shoqërore dhe thelbi I ndërgjegjes qytetare për të sotmen dhe të ardhmen e zhvillimit, në hapsirën kombëtare.

### **Monumenti I Konstandin Kristoforidhit**

Kjo është një vepër erëndësishme e skulpturës monumentale shqiptare e ngritur pas v. 1960, punuar nga skulptorët Kristaq Rama dhe Mumtaz Dhrami, e përruar më 24 nëntor 1962, në lulishten me të njëjtin emër, në krah të shëtitores kryesore të qytetit, ku krijon një kompleks unik me torrën lindore të kalasë dhe godinën e teatrit Skampa në kryqëzim me rrugën e Universitetit. Kjo hapsirë është me një pamje prezantuese për qytetin e Elbasanit. Figura është e kompozuar ulur dhe është vendosur mbi një kub të thishtë dhe të veshur me mermer të bardhë e me sfond të rrethuar nga pishat. Monumenti i është kushtuar babait të gjuhës shqipe që I parapriu kërkesave të popullit shqiptar për dije, liri dhe mëvetësi kombëtare. Kostandin Kristoforidhi është ulur , me librin eebetares përpara mbështetur mbi gjunjë, ndërsa shikimin e tret larg në përfytyrimin e historisë që do të rrjedhë më pas, mbi kombin shqiptar. Është realizuar me stil realist-dekorativ në modelimin e sipërfaqeve të figurës, me plastikë të qetë.

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Skulptura prezanton njëkohësisht aktivitetin e rilindësve elbasanas në shërbim të pavarësisë kombëtare dhe me frymën stilistike të kohës, kur u ngrit kjo vepër skulpturale.

### Monumenti i Aqif Pashë Bicakut

Është një nga krijimet më të rëndësishme të skulpturës monumentale në Elbasan, ngritur pas v. 1990, vepër e skulptorit Bujar Kapllani e realizuar në bronz me lartësi 2.9 metra dhe e vendosur mbi një platformë dhe bazament 2.7 metra të lartë. Kjo vepër komunikon me mjedisin nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë, që buron nga konceptimi unik i skulpturës, bazamentit dhe sheshit. Bazamenti është një platformë me dy hyrje kalimi të shkallëzuara në pjesën e pasme të cilat hapen në një udhë të madhe në pjesën ballore të monumentit, në mes të së cilës ngrihet një bllok masiv me sipërfaqe që ngjason me lëvizjet spirale të flamurit. Mbi këtë bazament ngrihet figura në bronz e patriotit me sfond hapësirën e degëve të rrapit dhe muret e kalasë. Figura e patriotit elbasanas ka dorën e majtë si kube mbi kraharor, aty ku rreh zemra dhe gishtin drejtues me drejtim nga flamuri kombëtar, i cili është në krahun e djathtë të shtatores ngritur mbi një shtizë natyrale. Kjo përforcon idenë se figura është e mbështetur në shtizën e flamurit

### Monumenti i Isuf Myzyrit

Figurë skulpturale në lulishten pranë sheshit "I Maji", në qytetin e Elbasanit, e përruar më 14 mars 2002 me rastin e 121 vjetorit të lindjes së Isuf Myzyrit. Është vepër e skulptorit nga Tirana Artan Peqini. Figura qëndron e vendosur mbi një kub të thjeshtë të veshur me mermer gri Brenda një përcelle me lule, midis trotuarit përballë kryqëzimit të rrugëve. Në sfond të figurës ndodhen godinat e institucioneve qendrore-administrative të qytetit. Skulptura i kushtohet kënkëtarit popullor, qytetarit të nderuar të qytetit, artistit të popullit Isuf Myzuri, i cili krijoi një fond të gjerë të këngës qytetare elbasanase të shek. XX, me vargje dhe melodi të krijuara nga ai vetë dhe të mbështetura në motivet e jetës së përditshme të kohës që jetoi. Figura e bronzit është paraqitur me violinë në dorë dhe poshtë faqes së majtë duke u përruar përballë publikut që e duartroket. Kjo skulpturë e realizuar në bronz ka madhësinë natyrale me përmasat e njeriut.

### Urat Antike

Ura që I përkasin periudhës antike, shek. II p.e.r deri në sek.VI e.r . Ekzistenca e shumë rrugëve në rajonin e Elbasanit gjatë kësaj periudhe kushtëzoi dhe ndërtimin e mjaft urave. Romakët nga shek. II p.e.r dhe në dy shekujt e parë të perandorisë, në kohën e perandorëve August dhe Adrian ndërtuan :

-ura druri, me shtresë dërrasash, mbi këmbë me mur guri

Urat e drurit janë më të hershmet se urat e gurit. ë kësaj periudhe është Ura e Topciasit mbi Shkimbin, në Elbasan, që i shërbente rrugës që fillonte nga Apollonia për tu lidhur me rrugën Egnatia. Këmbët kanë hapsirë 12 m njëra nga tjetra, janë ndërtuar me mur guri dhe përbëhet nga trugu, brendësia e murit është punuar me gurë lumi, me derdhje llaci të shumtë. Këmbët kanë qenë të lidhura ndërmjet tyre me trarë.

-ura guri me një qemer

Sipas gjerësisë së shtratit të lumit ku ndërtoheshin, urat ishin me një ose shumë qemerë. Nga burimet përmenden urat e gurit me qendër të Cobanajt, Kushës dhe e Muriqanit.

-ura guri me shumë qemerë

të tilla përmenden të ndërtuara në shek.II e.r janë ura romake, sot rrënojat e njëres prej këmbëve janë pranë urës së periudhës turke dhe ura e Kecit mbi Shkumbin.

### Urat Mesjetare

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Urat e shek . XV- XIX janë prej druri dhe me qemer guri, ato kanë funksionuar shumë por shumica prej tyre nuk ruhen më pasi materiali drusor nuk i ka rezistuar kohës. Ndër urat me qemer guri vlen të përmendet--ura mbi Gurrën e labinotit në fshatin labonot Fushë gjatë rrugës Elbasan-Ohër. Kjo urë është ndërtuar në shek . XVIII.

Ura Kamarës, pranë fshatit Mirakë e cila është urë asimetrike me tre qemerë , ka gjatësi 40m dhe gjerësi 3.5 m dhe midis tyre ndodhen dritare shkarkuese në formë lundre.

Ura e shkumbinit, mbi lumen me pot ë njëjtin emër përbëhej nga 10 qemerë gjysmërrethor dhe rreth 30 dritare shkarkuese, cerekrrethorë e gjysmërrethorë. Kjo urë e gjatë lidhte Elbasanin me Gramshin e Beratit.Ne vitet e fundit të shekullit XX ajo u restaurua.

Ura mbi përroin e Zaranikës është një urë e ngushtë, me pesë qemerë gjysmërrethorë, gjatë rrugës të luginës së Shkumbinit Durrës- peqin- Elbasan. Është ndërtuar në fund të shek. XVIII e fillim I shek.XIX.

### **Kalaja e Mengelit**

Kjo kala ngrihet në kodrën e Mengëlit,që ndodhet në pjesën jugore të masivit të Godoleshit.Ajo ngrihet mbi luginën e lumit Shkumbin në një lartësi 300 metra.Nga kjo lartësi kontrolloheshin plotësisht levizjet në rrugën Egnatiaqë kalonte në fundin e kodrës dhe shikoheshin qartë fortifikimet e Qafës dhe të Gadishtës së Belshit.Kalaja e Menglit ka formën e një shumëkëndëshi.

Faqet anësore të murit rrethues janë të punuara me gurë me madhësi mesatare dhe mbushja në mes është bërë me gurë të vegjël me sasi të madhe llaci.Trashësia e tyre arrin në 2 metra në anën jugore të kështjellës dhe në 2.3 metra në anët e tjera.Teritori I brendshëm I kësaj kështjelle është I mbuluar me gjurmë banesash të madhësive të ndryshme.

Hyrja e kështjellës gjendet në anën veri-perëndimore të saj,ndërmjet dy kullave katërkëndëshe,nr.1 dhe nr.2 e krijuar si rezultat I ndërprerjes së murit rrethues.Ajo është 3.5 metra e gjerë dhe duhet të ketë pasur një portë dyfletëshe.

Kalaja e Menglit përforcohet nga 8 kulla,që ndodhen në largësi të ndryshme nga njëra-tjetra në varësi të terrenit.Në përgjithësi ruhet bdistanca prej 40-50 metrash ndërmjet tyre vetëm në anën jugore dhe jugperëndimore ku terreni siguron një mbrojtje më efikase dhe largësia ndërmjet kullave rritet deri në 80 metra.

Prania e 8 kullave kushtëzohet nga fakti që ajo ndodhej pranë rrugës Egnatia arteria kryesore për të kaluar në perëndim.Mbizotëruese është forma katërkëndëshe por ndeshet edhe në një kulle në trajtën e formës U,e dalë plotësisht jashtë murit rrethues,kulla 6.Kulla nr1 dhe nr.2 shoqërojnë hyrjen e vetme të kalasë dhe kanë formë katërkëndëshe.Kulla nr.3 gjendet në largësi prej 37 metrash nga kulla nr.2,është katërkëndëshe dhe zë vend qëndror në vijën perëndimore të murit rrethues.Kullat 4 dhe 5 kanë formë katërkëndëshedhe ndodhen në skajet jugperëndimor dh juglindor të kështjellës atje ku pjerrësia e terrenit është më e madhe.Kulla nr 6 ka formën e U dhe ndodhet në kuotën më të lartë të kodrës në lartësi 300 metra.Kullat 7 ndhe 8 ndodhen në anën veriore dhe verilindore dhe kanë formë katërkëndëshe.Kullat katërkëndëshe zënë vend të rëndësishëm në sistemin mbrojtës të Kalasë së Menglit.Megjithëse kjo kullë krijon pika të vdekura për mbrojtësit te saj dhe paraqitet më e dobët se kullat rrethore ose disakëndëshe,ndërtuesit për të shmangur këtë btë metë kanë shtuar trashësinë e murit rrethues dhe të krahëve të kullave nga ana veriore, ku mund të ishte më I voitshëm sulmi.

Prania e këtij tipi kulle favorizohet nga lehtësia në anën ndërtimore dhe kërkon pak kohë.kalaja e Menglit perfaqëson një ndërtim ushtaraktë realizuar në kohën e sundimit të perandorit Justinian.Ajo paraqet tipare të përbashkëta me kalanë tjetër Bizantine,Atë të Qafës të ndërtuar po në kohën e Justinianit për të kontrolluar degën jugore të rrugës Egnatia.Kalaja e Menglit përfaqëson një ndërtim tipik të arkitekturës bizantine të shek.V.e.s.



### **Kështjella Skampis**

Qyteti I Elbasanit ka kështjellën e Skampis. Ajo përfaqëson një Castrum Statum. qendër e një legjoni romak. Si të gjitha kampet ushtarake romake edhe ky I skampis është ndërtuar sipas një plani orthogonal, I përcaktuar nga kryqëzimi në kënd të drejtë i dy rrugëve: decumanus në dretimin P-L dhe cardo në drejtimin V-J. kjo gjë ka përcaktuar dhe planimetrinë e saj. Kështjella ka formën e një katërkëndëshi kënddrejtë në përmasa 308 x 348 mdrejtuar në anët më të ngushta në drejtim VL-JP. Është e qarkuar nga një hendek 3m i thellë që mbushej me ujë nga përroi i Zaranikës. Ajo ka 4 hyrje që ndodhen në mes të cdo kurtine të cilat mbrohen nga kulla. Kështjella është epajisur me 26 kulla. Në katër qoshet e saj ndodhen kulla në formë freskoreje. Dytë tjera janë kulla hyrje dhe ndodhë në pjesën fundore të rrugës Cardo. Ato kanë planimetr katërkëndëshe ndersa njëzet të tjerat kanë formën e shkronjës U. Kullat janë plotësisht të dala jashtë murit rrethues, vetëm katër prej tyre që mbrojnë hyrjet e rrugës decumanus dalin përgjysmë jashtë murit rrethues. Të gjitha kullat e kështjellës pavarësisht nga forma e tyre dalin 8-9 m larg murit dhe gjenden 40-50 m larg njëra-tjetrës. Përbërja e murit rrethues tregon për tri periudha kryesore ndërtimi, që janë:

1. Periudha e vonë romake
2. Periudha e hershme bizantine
3. Periudha osmane

Muri I periudhës së vonë romake gjendet kudo në nivelin e poshtëm të kështjellës dhe përshkon gjithë planimetrinë e saj. Ngrihet mbi themelin e kështjellës dhe ruhet në lartësinë maksimale deri në 5m. Trashësia e murit rrethues është 3m. Ndërtimet e realizuara në teknikën e njohur opus mixstum, pëtrdorimi I brezit të tullave shërben si një lidhje e vërtetë ndërmjet dy faqeve të murit dhe bërthamës. Midis këtyre tri elementëve të ndryshëm sigurohet një lidhje e qëndrueshme.

Mendohet se lartësia e plotë e murit rrethues deri në shtegun e rojes ka qenë rreth 9 m. Pjesa e sipërme ka qenë e pajisur me shtegun e rojes, me një platformë të qarkullimit, vëzhgimit, mbrojtjes dhe me një parapet. Ky I fundit e ka trashësinë rreth 0,70 m dhe përbëhet nga gjoksburoja dhe hapësira goditëse. Lartësia e parapetit varet nga këndi I goditjes dhe me ndërtimet romake ai ka qenë rreth 2 m.

Me krijimin e sistemit të ri administrative dhe ushtarak bizantin, një pjesë e mirë e territoreve që ishin pranë qytetit Skampis dhe rrugës Egnatia përfshihen në themën e Durrësit. Këto territore u përfshinë në organizimin e ri administrative kishtar dhe u përkisnin peshkopatave të Durrësit, Kunavisë-Kandavisë, Cernikos-Cermenikës.

Materiali arkeologjik I zbuluar në kështjellën e Skampis për periudhat e shek VII-XV dëshmon për një rënie të theksuar të jetës në shekujt e parë dhe një rigjallërim i saj deri në prag të pushtimit osman. Në këtë periudhë, në këtë rajon ndeshen rrënoja të shumta të monumenteve kristiane në zonën e Shpatit Cermenikës, Kërrabës, Dumresë e Sulovës. Të dhënat dhe analiza në lidhje me të gjitha fortifikimet në Gadishullin e Ballkanit dhe më gjerë përcaktojnë që kështjella e Skampis është ndërtuar në kohën e perandorit romak Diklecian në v. 284-305 e.s. Shtudimet arkeologjike dëshmojnë për një ndërprerje të jetës në këtë qendër pas betejës së Adrianopolit në v. 378 dhe dyndjes së fiseve vizigote drejt pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik.

Pas kalimit të vizigotëve me Alarikun në krye për në gadishullin Apenin situatë u rivendos dhe jeta vazhdoi normalisht deri në dyndjen tjetër të fiseve ostrogote pas gjysmës së parë të shek. V.

Gjatë periudhës ndërmjet dy dyndjeve të njëpasnjëshme të fiseve gotë mendohet se Skampisi si rezultat I zhvillimit ekonomik që bazohej në stabilitetin e Perandorisë Romake, u shndërrua në një qytet dhe u bë njëkohësisht qendër e rëndësishme ekonomike dhe qendër peshkopale.

Në kohën e sundimit të perandorëve Anastas dhe Justiniani I parë, ka një stabilitet të jetës në krahinë. Pothuajse është vendosur siguria, ndihet një rritje ekonomike, e cila shihet në marëdhëniet tregtare në këtë periudhë me Mesdheun Lindor dhe më pak me Afrikën Veriore.

Kështjella Skampis duhet të ketë qenë mjaft e dëmtuar në kohën e perandorit Justinian (527-565) kur ajo rindërtohet për faktin që Pokopi I Cezaresë cilësohet si ndërtim I mirëfilltë. Në këtë kohë Kështjella

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

ka pësuar riparime me karakter të përgjithshëm që vihen re edhe fundshekullin XX në disa trakte muresh.

Gërmimet arkeologjike të kryer në territorin e saj nxorrën në dritë pjesën veriore të atriumit të një bazilike të epokës paleokristiane. Mbi dyshtimin e atriumit u gjetën disa elementë arkitektonikë paleokristianë. Zhvillimi i jetës në qytetin e Skampis dhe në zonën rreth tij do të pësojë një goditje të fortë në fillim të shekullit të VII në kohën e dyndjeve të tjera, kësaj rradhe nga avarosllavët.

### **Kulla monumentale e orës**

Karakteristike e qyteteve shqiptare, në krahasim me qendrat e tjera urbane të Perandorisë Osmane, ishte prania në mjediset e tyre urbane që nga mesi i shek. XVI, i kullave të posacme në të cilat kishte orë për matjen e kohës. Përgjatë shek. XVII ishin pajisur me të tilla objekte pothuaj të gjitha qendrat qytetare, si Prizreni, Berati, Shkodra, Prishtina, Peja, kruja dhe Elbasani. Idenë për ndërtimin e tyre e kishin sjellë tregtarët vendas, në kontakte të shpeshta me qytetet europiane. Ata sollën prej andej edhe mekanizmat kohëmatës, për të cilët ndërtuan kulla të posacme në sheshet e pazareve apo në vende pranë tyre të zgjedhura, që kulla të bëhej element mbizotërues i siluetës së qytetit. Në Elbasan si vend për ngritjen e saj u pëlqye kulla e hyrjes së kalasë pranë xhamisë së Fatiut, të cilën Evlija Çelebiu e cilëson shumë të bukur dhe që funksiononte shumë mirë. Në formën e saj të hershme ky sahat qytetar nuk njihet, madje në të njëjtin vend vërtetohet që janë ngritur radhazi tre të tillë, njëri i përkohshëm me strukturë druri dhe i fundit që njohim, sic thuhet në mbishkrim, u ngrit me mirësinë e banorëve të qytetit në vitin 1899. Kulla ngrihet në lartësinë me trek atë funksionale, me planimetri katrore 4.3m x 4.3m. Në ballin nga qyteti ndodhet porta e hyrjes, mbi harkun e së cilës është shkruar historiku i ndërtimit të saj. Teksti i mbishkrimit është: "Mbreti i botës Abdylhamiti bujar/në hijen e hirit të tij u ngrit sahati i hijshëm/burra me sedër të Elbasanit patën mirësinë/dhe ngjallën këtë kohëregues të bukur dhe zemërledhatues/shumë u përpoq, u kujdesua dhe u interesua Aqif beu/Zoti i dhshtë si shpërblim gjithë të mirat e kësaj bote/kur tingëllon, me zërin e tij njofton për bukuri kohën e saktë/ në mënyrë të përsosur nga të katër anët tregon minutat/meqë zotëron intuitën e vjershëtorit tuaj/o Refit vitin e ndërtimit ttij/ë ndërtuan në fillim të vitit 1315.

Artistikisht Kulla e Orës së Elbasanit është një gjetje origjinale në propocionet dhe në trajtimin dekorativ të strukturave të jashtme.

### **Kalaja e Qafës në Sulovë.**

Ngrihet mbi një kodër shkëmbore dhe ka pozitë dominuese në këtë luginë. Sipërfaqja është jo më pak se 1 ha. Pjesa e sipërme e kodrës, ku ngrihet K.Q.S., ka formën e një pllaje të vogël që kufizohet me shpate të mëdha në J e P dhe zbret butë në anët e tjera. Vetëm pjesa më e lartë, me sipërfaqe 0.8 ha, që ndodhet në anën JL të pllajës, përfshihet Brenda mureve rrethuese të saj. Muret e K.Q.S., në përgjithësi, ruhen mirë. Ato përforcohen nga kulla që ndodhen 33.5-40.5 m larg njëra-tjetrës dhe kanë gjerësi 2.30-2.50 m. Ruhen në lartësinë maksimale 5 m, po të shtojnë dhe lartësinë 2 m e gjoksburojës lartësia arrin 7 m. Janë ndërtuar me gurë gëlqerorë në trajtë rrasash. Llaçi i përdorur për lidhjen e gurëve është i përgatitur me gëlqere të bollshme dhe është i cilësisë së mirë.

K.Q.S. ka 5 kulla që shquhen për format të ndryshme planimetrike. Kulla nr.1 ka formën katër këndëshe dhe ndodhet në anën JL të kështjellës. Kullat 2,3,4 ndodhen në V të kështjellës. Janë 33.5-38 m larg njëra-tjetrës. Forma e tyre është trekëndëshe me kulm të prerë. Ndërtimi në këtë mënyrë duhet të shpjegohet me goditjen më të madhe që duhet të përballonin gjatë luftimit. Kulla nr.5 ndodhet në P. Ka formën e shkronjës U. Kalaja ka një hyrje që gjendet në skajin JL të saj. Ajo është krijuar si rezultat i dërprerjes së murit rrethues dhe mbrohet nga kulla nr.1 që ndodhet pranë saj. Një nga elementet interesante të murit rrethues është një shkallë ngritjeje e vendosur 6.5m përpara kullës nr.2.

Me gjithë pozitën e favorshme stradegjike me mure që shkojnë nga 2.30m x 2.5m të trasha, të pajisura me kulla, ndërtuesit, për të rritur më tej aftësinë mbrojtëse në P dhe V kanë ngritur një protekizëm, i cili është larg murit rrethues 10-20m dhe i trashë 1.4m. Është i ndërtuar me gurë të veghël e mesatar. Shtrihet në jo më shumë se 110m gjatësi.

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Brenda mureve rrethuese janë gjetur 13 banesa dhe një material I pasur arkeologjik, midis tyre dhe 7 monedha, nga të cilat 3 janë të lexueshme. I përkasin Justinianit I(v.527-565). Elementet arkitektonike, teknika e ndërtimit, materiali arkeologjik dhe monedhat e gjetura, përcaktojnë qartë se K.Q.S. është një ndërtim tipik I arkitekturës bizantine në shek.VI.

### **Manastiri i Gjon Vladimirit.**

U rindërtua nga Karl Topia në shek. XIV, mbi rrënojat e një ndërtua më të vjetër dhe u bë 4 herë më I madh, siç del nga mbishkrimet. Janë tri mbishkrime: latinisht, greqisht dhe sllavisht, me përmbajtje të përafërt, ku thuhet se Karl Topia, mbret I shqiptarëve e ka bërë manastirin për lavdinë e tij. Ky manastir është një nga qendrat më të mëdha kulturore kishtarë të Shqipërisë. Ai ka mbijetuar deri më 1944, kur u dogj dhe tani kanë mbetur vetëm muret. Është një monument historic shumë I rëndësishëm I mesjetës shqiptare. M.Gj.V. ka pasur një bibliotekë të madhe, që ka humbur, si dhe një koleksion të shkëlqyer ikonash, disa prej të cilave ruhen ende. Në mure ka disa skulptura dhe ornamente më të hershme se të shek.XIV, mbishkrime më të vona, si dhe ka qenë portali I gdhendur mjeshtërisht që është marrë dhe montuar në Muzeun Historik Kombëtar.

### **Muzeu i shkollës normale**

Projekti për ngritjen e shkollës Normale i takon V.1934, që nga përkonte me krenntimin e e 25 - vjetorit të themelimit të Normales. Por nuk u arrit nga djegja aksidentale e godinës së shkollës së vjetër më 1934 bashkë me dokumentacionin e vyer.Më 1959, me ekspozitën e punëve të pavarura të nxënësve që u hap me rastin e 50 - vjetorit të shkollës, rrethi i historisë me mësuesin Shyqyri DEMIRI kriuan një kënd muzeal me fotografi e kujtime nga jeta në shkollë. Më 1969 u bë ekspozimi kronologjik I fundit arkivor të grumbulluar posaçërisht për muzet. Më 1979, në kuadrin e 70- vjetorit të shkollës me porosi nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, u ngarkua një komision në shkollë për ngritjen M.SH.N. Ai qe një fasadë arritjesh të shkollës pas Luftës së II Botërore duke mos i paraqitur vlerat dhe kontributin e gjithanshëm të kësaj shkolle për arsimin kombëtar.

Në V. 1993, u rikonceptua ringritja e M.SH.N. për të dhënë me vërtetësi vlerat dhe kontributin. Kjo u bë e mundshme edhe nga bashkëpunimi me Akademinë e shkencave dhe institucionet e tjera studimore kombëtare, si dhe figura personalitete, kryesisht ish- normalistë. Në fundshekullin e XX ai u vendos në katin e dytë të shkollës në një mjedis prej 80 m2 të rikonstruktuar

Posaçërisht për muze.

Muzeu ka një fond prej mbi 5000 dokumentesh origjinale e fotokopje, të marra nga A Q SH dhe të institucioneve të tjera studimore.

Janë edhe rreth 500 portrete, përfaqësues të brezave normalistë. Në vitrina tërheqin vëmendjen dhjetëra dosje dokumentesh, albumesh fotografikë, relike të shumëllojshme, botime të së kaluarës dhe të së tashmes, revista , regjistra, portokolle të këshillit pedagogjik, kujtime t ëish normalistëve. Fondi i M.SH.N. plotësohet me kujdesin e historianit të shkollës Genc Trandafili, që hulumton në dobi të pasurimit të muzeut.

### **Stema e Karl Topisë.**

Stema e Karl Topisë. Ndollet në anën e majtë të Portalit të Manastirit të GJon Vladimirit. Ka formë katërkëndëshe dhe përbën jo vetëm një vepër arti, por edhe një nga stemar më të rëndësishme të historisë së heraldikës shqiptare.

Ajo paraqet një luan të ulur në një front ë vogël, si dhe një numër kryqesh të tipit grek, brendashkruar në rreth dhe kryqe të tipit grek latin. Në stemë janë dhe simbolet e zambakëve, që përfaqësojnë stemën heraldike franceze, anzhvine. Vetë Karli ishte bir nga ana e nënës i gjakut mbretëror francez, anzhuin.

### **Xhamia mbretërore**

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Njëra nga faltoret më të herëshme të Shqipërisë dhe që ruhet në formën e saj të themelimit është xhamia brenda *kalasë së Elbasanit* në distancë të afërt me portën kryesore të hyrjes në kala. Për qytetin ajo vinte e dyta në radhë; pas xhamisë së ndërtuar nga Sulltan Mehmeti i dytë në v. 1464 kur u ndërmorën shumë punime për restaurimin e mureve rrethuese të kalasë.

Mbishkrim datues nuk njihet deri tani, por pa mëdyshje ajo I takon fundit të shek. XV e lidhur kjo me themeluesin e saj. Në shkrimin e tij mbi Elbasanin Evlija Çelebiu përbrenda kalasë një xhami të Gazi Sinan pashës e cila sipas tij ishte "ndërtesë e madhe por e vjetër përdhese". Ai gjithashtu vëren se muret e saj ishin të mbuluara me shkrime të ndryshme në faqet e jashtme që na bënë të mendojmë se ajo ishte e suvatuar, por që nuk kishte minaret. Këto veçori të xhamisë nuk perputhen me xhaminë që ndodhet në shek. XX në kala të emëruar e Mbretit. Leon Rein ë fillim të shek. XX e prezanton atë me karakteristika krejtësisht të ndryshme nga xhamia e Gazi Sinan pashës. Nba pikëpamja sylistike kjo faltore përputhet me të gjitha xhamitë e tjera të emëruara mbretërore që u ndërtuan nga Sulltan Bajaziti I dytë, në fund të shek. XV në Përmet, Gjirokastër, Berat, Shkodër dhe pse jo në Elbasan.

Xh.M. përfaqëson tipin e faltores me sallë të mbuluar me çati druru dhe hajat përpara hyrjes. Salla e faltores ka një hapësirë 11.5 x 12.3m. Tërthor aksit të saj, tri kolona druri për arsye konstruktive të mbajtjes së çatisë dhe për të krijuar një mjedis ndarës të sallës nga pjesa e mafilit, janë karakteristike për këto lloj kompozimi të faltoreve të hershme islamike. Në murin fundor është theksuar në formën e një nikeje rrethore dhe e kornizuar mihrabi, pranë të cilit ngjitur me të në krahun e djathtë ndodhet shkallarja e minberit. Prapa kolonadës treshe ndodhet mafili prej druri. Xhamia merr dritë nga katër dritare në secilën faqe. Të poshtmet janë kuadratikë. Në pjesën e sipërme ato mbyllen me arkitrarë druri, duke pasur nga ana e jashtme nga një hark të verbër me majë, në formë lundre. Dritaret e sipërme janë të harkuara. Muratura me kluasonazh është tepër e rregullt dhe precise në alternimin e gurëve e gurëve me tullat kornizuese. Me kluasonazh është ndërtuar dhe minareja. Ajo është e ulët si lartësi, por kalon mjaft bukur trupi në ballkonin e sherifasë e me seksion më të ngushtë në pjesën e sipërme ku mbështet koni i majës, i realizuar me fletë metalike prej plumbi. Hajati i Xh.M. ka qenë i realizuar prej strukturash druri disa herë pothuajse me të njejtën mënyrë, me përjashtim të atij të rikonstruktuar vitet e fundit të shek. XX, që nuk i përlligjet shkencërisht. Për këtë xhami parashikohen ndërhyrje të tjera restauruese të cilat synojnë restaurimin e minares dhe trajtimin estetik të fasadave të jashtme dhe mjedisit rrethues.

### **Namazgjaja.**

Në fundin e shek. XV, qyteti i Elbasanit mori një shtrirje të fjerë jashtë mureve të kalasë, duke arritur përgjatë një shekulli përmasat e një qyteti të madh të kohës. Varoshi ndahej në 18 lagje të banuara nga qytetarë të besimit islam e 10 lagje me banorë të krishterë. Në qytet dalloj ndër të tjerë edhe Namazgjaja, një shesh lëndine i rrethuar me 60 selvi të larta. Me drejtimin nga kibla, ajo kishte të theksuar nikenë, mihrabin dhe shkallaren e minberit të realizuar me strukturë guri. Reth e rrotull një bordurë prej guri dhe kangjella druri qarkonte sipërfaqen e namazgjasë në të katër anët.

Kjo N. ishte në përmasa të mëdha dhe mendohet se ajo vinte e para ndaj të gjitha të tjerave të ndërtuara në Shqipëri.

### **Teqja e Baba Xhemalit (1929)**

Është ngritur mbi themelet teqesë së Baba Ali Horosanit i cili tragjikisht u vra në Elbasan më 1862. Baba Xhemali ka qënë , dijetar, i lindur në Stamboll, nga brezi i iman Ali Rizajt dhe ka shërbyer në Bagdat, Stamboll. Më 1926 vjen në Shqipëri dhe vendoset në Elbasan në regjistrat e vjetra të vakëfit figuron për trullin e saj se " Teqja e Baba Ali Horosanit ndodhet në anë të lumit Shkumbin pranë Tyrbes së Gocës". Mbi të baba Xhemali më 1929 ngre ndërtesën e re. Fitoi besim dhe emër me punën e tij. Vdes në Elbasan. T.B.Xh. funksionon si institucion fetar.

### **Teqja e Madhe (1803)**

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

Qendra Bektashiane në Elbasan është themeluar nga dy shenjtorë të tyre, Fakri e Xhefai Babai. Fakriu rrjedh nga fisi timuri I cili sot quhet Hajrullau, ndërsa fisi Xhefai rrjedh nga fisi I Haskajve që ekzistojnë dhe në fundshekullin XX. Baballarët të cilët kanë drejtuar T. M. kanë qenë nga familje të njohura të këtij qyteti, si familja Balza, Ekmekçiu dhe veçanërisht nga familja Dedei, pesë pjesëtarë prej së cilës kanë drejtuar e rindërtuar Teqen e Madhe gjatë v. 1874 – 1962. Në këtë teqe të vendosur në të majtë të rrugës nacionale Elbasan – Korçë në kodrën e bukur të qytetit kanë shërbyer me përkushtim deri në v. 1967 12 baballarë. Themeluesi i T. M. të Elbasanit është Fakri Mustafa Babai. Ai e themeloi në v. 1803. Veprimtaria e saj e gjithanëshme patriotike, kulturore dhe shpirtërore bëri që populli ta quajë me emrin "Teqja e Madhe". Me thirrje dhe kërkesën e bërë nga Fakri Mustafa Babai erdhi në Elbasan Xhefai Ibrahim Babai. Të dy në bashkëpunim me njëri – tjetrin themeluan Teqen bektashiane e cila mori emrin e tyre, Teqja "Fakri Xhefai Babai" Xhefai Ibrahim Babai ka qenë dervish i Qemaledin Shemin Ibrahim Babait të Fushë Krujës. Në v. 1826 me prishjen e Teqes nga autoritetet osmane largohet nga Elbasani dhe shkojnë mysafir në fshatin Luz i Madh të Kavajës, në shtëpinë e Ibrahim Xhanit, në familjen e Hysajve. Kjo familje i premtoi se jeta e tij ishte e sigurtë në këtë shtëpi nga ndjekjet dhe persekutimet e qeveritarëve osmanë. Xhefai Babai në Frashëer qendroi tre vjet. Në v. 1829 kthehet në Elbasan në shtëpinë e motrës së tij. Këtu kaloi pak kohë dhe ndërroi jetë. Një rol të rëndësishëm në drejtimin e teqes ka luajtur dijetari i shquar Ali Baba Dedei. Ai e drejtoi teqen në v. 1874-1897, për 23 vjet me radhë. i pajisur me kulturë të thellë dhe të gjithëanëshme dhe duke zotëruar mjaft mirë turqishten arabishten dhe persishten, ajo fitoi vetëm respektin dhe simpatinë e besimtarëve bektashian, por edhe të besimit mysliman dhe ortodoks. Populli e thërriste Hylki sepse kishte gjykim dhe arsytim të thellë dhe moral të lartë. Ndërroi jetë në 14 shkurt 1897. Zëvendësuesi I tij ka qenë Sali Baba Dedei. Dhe ky Baba e drejtoi teqen për 17 vjet nga v. 1897-1914. Ai ka vizituar Teqen e haxhi Bektash Veliut, themeluesit të bektashizmit dhe atje është graduar Halife (Gjysh).

### Monumentet e rrethit të Elbasanit

1. Bazilika e Klosit në fshatin Klos të Sulovës.
2. Bazilika në kodrën e Tepes pranë qytetit të Elbasanit.
3. Gradishta e Belshit në fshatin Belsh.
4. Gërmadhat antike në fshatin Bradashesh.
5. Hamami i pazarit në qytetin e Elbasanit.
6. Hamami i vjetër në lagjen "Kala" të qytetit të elbasanit.
7. Kala e malit në fshatin Xherije.
8. Kala në kodrën e Kalaja në kodrën e Saragut në fshatin Pajovë.
9. Kalaja e Bodinit në fshatin Bodinit.
10. Kalaja e Dragotit në fshatin Dragot.
11. Kalaja e Elbasanit në qytetin e Elbasanit.
12. Kalaja e Gurit në fshatin Lleshan.
13. Kalaja e Kabashit pranë fshatit Jeronisht në Shpat.
14. Kalaja e Kazijes në fshatin Kazije.
15. Kalaja e Menglit pranë qytetit të Elbasanit.
16. Kalaja e Peqinit në qytetin e Peqinit.
17. Kalaja e Valëshit në fshatin Valësh.
18. Kalaja në fshatin Qafë të Sulovës
19. Kalaja në Llixhat e Elbasanit.
20. Kalaja në majën e Qytetit dhe kalaja në majën e Shën- Mërisë në fshatin Bixhëllonjë.
21. Kalaja në Shkëmbin Mbret në fshatin e Xibrakë.
22. Kalaja në vendin e quajtur 'Kulla e Gracnit në fshatin Gracen.'
23. Kalaja në vendin e quajtur Kulla e Kamanakut në fshatin Kamunak.
24. Kalaja në vendin e quajtur Shkëmbi I Shënlliut në fshatin Petresh.

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

25. Kisha e Shën- Mërisë në kalanë Elbasanit.
26. Kisha e Shën Thanasit.
27. Kisha e Shëna–Premtes në fshatin Valësh.
28. Kisha e Shën-Gjon Vladimirit në fshatin Shijon.
29. Kisha e Shën-Kollit në fshatin Shelcan.
30. Kulla e Sahatit mbi muret e Kalasë së Elbasanit.
31. Kulla e Sahatit në qytetin e Peqinit.
32. Këmbët e urës antike në Topçias.
33. Manastiri i Gjon Vladimirit.
34. Monumenti i Aqif Pashë Bicakut
35. Monumenti i Isuf Myzyrit
36. Monumenti ionstandin Kristoforidhit
37. Muzetë
38. Muzeu i shkollës normale
39. Namazgjaja në qytetin e Elbasanit.
40. Pusi që lahet vetë dhe rrapit pranë tij.
41. Rrënojat antike në Pellaz të fshatit Uruçaj.
42. Rrënojat e Kishës në fshatin Belsh.
43. Rrënojat e kishës në fshatin Bixhëllonjë.
44. Rrënojat e kishës në fshatin Mamël.
45. Rrënojat e kishës së Ungjillëzimit në fshatin Mjekërs.
46. Rrënojat e urës antike në fshatin Fatishe.
47. Stema e Karl Topisë.
48. Teqja e Baba Xhemalit (1929).
49. Teqja e Madhe (1803).
50. Ura antike në fshatin Muriqan.
51. Xhamia e Ballies.
52. Xhamia e Nazireshtës në qytetin e Elbasanit.
53. Xhamia Mbretërore.

### **Bazilika e Klosit**

Në fshatin Klos të Sulovës në rrugën që kalon pranë kalasë antike të Qafës gjenden rrënojat e një bazilike. B. K. është trenefëshe në arkada mbi pilastra drejtëkëndëshe. Gjatë ekzistencës së saj bazilika ka pësuar transformime. Mendohet se është ndërtuar në shek. XIII- XIV dhe përbën një dëshmi me rëndësi, si ndërtim në një zonë fshatare.

### **Bazilika në Tepe.**

Bazilika në Tepe të Elbasanit ndodhet në ullishtat e qytetit shumë pranë tij, ç'ka tregon se bazilika I takon varrezës së Skampisit. Është e drejtuar nga lindja. Ajo u gjet me mure që ruhen pak mbi tokën U përkiste disa fazave ndërtimore. Faza e parë e ndërtimit paraqet një bazilikë me tri mjedise të formuara nga dy kolona. Muret mbi të cilët mbështetet, janë ndërtuar me gurë dhe breza 3-4 rradhësh tulle. Lartësia e plotë e murit ka qenë 5,5 m. Në fazën e dytë në kishë u bënë një sërë transformimesh, për t'ia përshtatur më mirë përdorimit si kishë varrezash, funksionin që mund të ketë pasur që në fillim. Këto ndryshime lidhen me futjen Brenda saj, në nefin verior, të dy varreve me qemer tullash. Dyshemeja e kishës në këtë kohë ndahet nga rrugët me pllaka shtuf në 4 panele mozaiku, dy nga dy, simetrie kryesisht me motive bimore e gjeometrike.

Kolonat e ikonastasisit janë prej mermeri grit ë prura nga një vend tjetër. Në pllakat e ikonastasisit me përmasa 102x92 cm, janë gdhendur luanë, kaprollë, shpendë të ndryshëm, krahas ornamenteve bimore. Ky rindërtim datohet në shek. V e.s. . Më vonë monumentit I është bërë një ndryshim në anën

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

perëndimore. Ndryshimi është bërë në shek. VI e.s. dhe përkon i njëjtë me atë të një rindërtimi në kalanë e Elbasanit.

Me rrënimin nga tërmetet, mundet që në v. 518 kisha, nuk rindërtohet më, sepse Skampis kishte katedralen e Shën Pjetrit, që përmendet në dokumente dhe se në këtë kohë lejohej varrimi Brenda kalave. Nga ky monument ndërtuar brenda kalasë janë gjetur kapitete e kolona dritaresh.

### **Xhamia e Ballias**

Faltore, stili i së cilës bën pjesë në periudhën e dytë të zhvillimit të arkitekturës shqiptare islamike, kur modeli klasik osman i xhamisë përhapet në të gjitha trevat e Rumelisë. Për qytetin e Elbasanit ajo vinte e dyta në kohë, pas xhamisë së Nazireshës, me të cilën kanë të njëjtënj gjuhë tipologjike. Elementet e saj përbërës funksional: salla e faljes, portiku në ballin e hyrjes dhe minareja në të djathtë plotësojnë siluetën me një kupolë gjysmësferike të lartësuar me një tambur polygonal tetëkëndor. Elementi më tërheqës i xhamisë ishte minareja që konkuronte të gjitha të tjerat me modelimin dekorativ original të saj sin ë zhvillimin e trupit në lartësi, por edhe ballkonit, i vetmi i këtij modeli në Shqipëri.

### **Xhamia e Nazireshës**

E para faltore monumentale e konceptuar në stilin klasik osman, përse I përket I formulimit planimetrik dhe vëllimor. Nëpërmjet teknikës së ndërtimit ajo ndërlidh në vazhdimësi traditën e artit të ndërtimitarisë në periudht pararendëse. Mbishkrimi datues nuk ka, por, prej mënyrës së kompozimit, ajo nuk mund të jetë ndërtuar në gjysmën e parë të shek XVI, në dekadën e fundit të tij. Sipas një mbishkrimi të shkruar me bojë në numrin fundor të mafilit lexohet data 1599, e cila së paku nënkupton ndërtimin e xhamisë pas kësaj date. Xhamia e Nazareshës ruhet në formën origjinale të sallës së faljes dhe të minares. Salla në përmasa kuadratike, ndricohet nga pesë dritare në tri radhë. Dritaret e poshtme janë të krizuara me patura të profiluara prej gurësh të gdhendur. Pamja ballore e xhamisë paraprihej nga një portik i mbuluar me çati druri nga i cili kalohëj në sallën e faltores nga porta, e cila ndrushe nga xhamitë e tjera ndodhet në qoshen e djathtë pranë trupit të minares. DysHEMEJA e xhamisë është e shtruar me pllaka poligonale prej qeramike, ashtu si të gjitha xhamitë e tjera të vendit që u ngritën ndërmjet viteve 1550-1600.

Xh.M është shpallur monument kulture, si një nga monumentet përfaqësues të historisë së arkitekturës mesjetare shqiptare.

### **Muzeu historik**

Muzeu Etnografik I Elbasanit është ndërtuar në një shtëpi karakteristike me cardak që I takon shekullit XVIII. Elbasanasit e njohin si shtëpia e Sejdinëve. Është një shtëpi që nga mënyra e ndërtimit dhe arkitektura është e vecantë në llojin e vet në trevën e Elbasanit. Në planin kompozicional dhe në përgjithësi në konceptimin e saj funksionalo-arkitektonik, kjo banesë I ngjan shumë banesave me cardakë që gjejmë në Berat e Shkodër. Banesa përbëhet nga dy kate : kati I parë ka qenë përdorur si magazinë ku futeshin prodhimet bujqësore dhe ka këto ambiente muzeale:

1-koridori

2-dhoma e leshrave

3-dhoma e metaleve

4-dhoma e tabakëve.

Kati I dytë ka qenë përdorur si vend banimi dhe përbëhet nga këto ambiente:

1-koridori

2-dhoma e punës së vajzave

3-dhoma e grave

4-dhoma e burrave

## Biblioteka Elbasanit "Qemal Baholli" - Shkrimtarë elbasanas

5-dhoma e nuses

Banasa është restauruar nga monumentet e kulturës në vitin 1983-1985 dhe në vitin 1986 ambientet e shtëpisë u përshtatën duke u kthyer në muze etnografik

### **Kisha e Shën Marisë në Kalanë e elbasanit**

Kisha e Shën Mërisë ndodhet në lagjen Kala. Në vitet 1657, 1661 kisha funksiononte rregullisht. Më 11 nëntor të vitit 1819 kisha u dogj plotësisht. Në periudhën 1826-1833 ajo u rindërtua. Planimetria e saj është interesante. Në qendër ka një sallë të madhe të mbuluar nga një kupolë mbi tambur. Kapela mbështetet në harqe në muret anësore ndërtuar pranë trupit të kishës. Kisha është ndërtuar me gurë e tulla dhe nuk ka një ndërtim me nivele të barabarta. Kubeja e saj është e mbuluar nga piktura të realizuara në vitin 1856. E vecanta e kësaj kisha qëndron tek figura Ikonostasit e gdhendur nga 40 mjeshtra dibranë të cilët punuan për rreth dhjetë vite për ta realizuar atë. Kjo figurë është lyer me llak ngjyrë floriri. Kisha e Shën Merisë dhe shquhet për vlerat e saj arkitekturore.

### **Kisha e Shën Thanasit**

Kjo kishë ortodokse ngrihet në skajin verior të qytetit të Elbasanit, u ndërtua në vitin 1846. Fillimisht u ndërtua me përmasa të vogla, prej druri. Ajo ka shërbyer për mbajtjen e ceremonive mortore të popullsisë ortodokse të lagjes Kala, pranë saj ndodheshin dhe varrezat. Në vitin 1942 realizohet ndërtimi i një kisha të re e cila zëvendësoi të vjetrën dhe u ndërtua me karakteristikat ndërtimore e arkitektonike të kishave të tjera të qytetit. Ceremonia e parë mortore është bërë një qytetarje të ardhur në Elbasan më 1846, e njohur si Maria e Qyqes.

### **Historiku I themelimit të qytetit të elbasanit**

Studimet arkeologjike dëshmojnë se jeta në truallin e qytetit të Elbasanit ka filluar në shekullin I pas Krishtit. "Në tokën e Eurodejeve, skampis..." Ptolemeu kumton të dhënë e parë për elbasanin e lashtë në shekullin II të erës sonë. Gjithashtu Skampis përmendet në internerarin e Antonimit, tabelën e Peutingerit dhe në internerarin e Bordos. Përveç dokumentave të shkruara monumenti që vërteton arkeologjikisht vendndodhjen e Skampis është guri mortor i legjionarit Mark Sabitis. Në mesin e shekullit të II pas Krishtit Skampis ka qenë Vicus që varej nga Dyrrahu. Në kohën e sundimit të perandorit romak Deoklician (284-305 p.k.) u ndërtua kështjella e Skampis në funksion të arterit të fuqishëm rrugor Vija Egnatia. Kështjella romake, përbën zanafillën e qytetit të ardhshëm të Skampisit. Gjatë shekullit IV, Skampis njohu një periudhë lulëzimi ekonomikë, u ndërpre nga dyndjet e fiseve gjermanike visigote dhe gjatë shek. V p.k nga ostrogotet. Gjatë sundimit të perandorëve Ilirë Anastas (492-518) dhe Justiniani (527-565), qyteti njohu një rigjallëri të jetës në të gjitha fushat. Në këtë periudhë rindërtohen muret rrethuese të qytetit. Në pranverë të vitit 519 delegatët e Papës Hormistos, pritën me nderime nga qytetarët në katedralen e Shën Pjetrit. Në këtë kohë Skampis është një qendër e rëndësishme ushtarake e peshkopale. Ashtu si lindjen edhe zhvillimin ia detyroi rrugës Egnatia po ashtu rrënimi dhe harresa i erdhën po prej saj. Në fillim të shekullit VII dyndjet avaro-slave ndërprejnë zhvillimin e jetës në këtë qendër urbane. Në shekujt e mëvonshëm historia e Skampis është lidhur me pushtimin bullgar. Për herë të fundit Skampis përmendet në vitin 1338 në dokumentet historike. Mbas kësaj kohe kjo qendër do të thirret Valmi ndërsa emir antic i qytetit do të kalojë lumit që rrjedh pranë tij. Inkursionet osmane në shqipëri, detyruan sultan mehmetin II të rindërtojë kështjellën romako-bizantine në muajin qershor të vitit 1466 dhe e quajti atë Ilj-basan (vend dominues) që në gojën e popullsisë vendase shquhet Elbasan.

*D. D. C; 908*

*Vendndodhja: E 52*